III-120	Korrespondencë, etj. mbi koncesionet e cigareve dhe duhanit.	06.20.1921 - 08.18.1921	19
III-122	Telegram mbi paraqitjen e aktkoncesionit për kanalin e Shkumbinit.	05.01.1921	2
III-123	Vendim, etj. mbi koncesionet për shfrytëzimin e pyjeve.	10.23.1921 - 10.28.1921	3
III-124	Vendim mbi koncesionet e ndërtimit të rrugëve, shtëpi, etj.	01.28.1921 - 11.02.1921	15
III-125	Vendime, etj. dhe korrespondenca të Kryeministrisë me Ministrinë e Punëve të Jashtme mbi lidhje kontratash për specialistë të huaj.	10.24.1921 - 12.29.1921	6
III-126	Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme me Kryeministrinë mbi paraqitjen e disa mostrave metali dhe guri.	02.19.1921 - 12.29.1921	5
III-127	Kërkesë e disa personave për të lejuar formimin e një shoqërie anonime për ngritjen e një fabrike alkooli në Shqipëri.	07.19.1921 - 07.29.1921	2
III-128	Vendim, etj. dhe korrespondenca të Kryeministrisë me Ministrinë e Punëve Botore e Ministrinë e Bujqësisë mbi emërimet, pushimet, transferimet të personelit të Ministrisë së Punëve Botore dhe të Ministrisë së Bujqësisë.	11.02.1920 - 12.30.1921	103
III-129	Korrespondencë mbi emërimet, transferimet, pushimet të kuadrit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Pyjeve.	04.13.1921 - 09.11.1921	7
III-130	Korrespondenca të Kryeministrisë me Ministrinë e Financave mbi ankimet që bëhen kundër nëpunësve pyjorë.	09.12.1921	3
III-131	Vendim, lutje dhe korrespondencë mbi nevojat e një interpretimi mbi pikat që lidhen me degët e bujqësisë, pyjeve, etj. të Ministrisë së Bujqësisë dhe mbi sjelljen e specialistëve të huaj.	07.21.1921 - 10.24.1921	10
III-132	Vendim mbi dorëzimin e fermës model të Selenicës degës së bujqësisë në Vlorë.	07.11.1921 - 07.16.1921	2
III-133	Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme me Kryeministrinë, mbi dorëzimin e tokës si pasuri e shtetit në Lushnjë, shkollës bujqësore.	06.21.1921	1
III-134	Lutje e një personi drejtuar Kryeministrisë mbi dhënien tokë nga pasuria e shtetit për një shtëpi në Lushnjë.	02.18.1921	1
III-136	Vendim dhe korrespondencë e Kryeministrisë me Ministrinë e Punëve të Brendshme mbi vartësinë e tokave që janë pasuri e shtetit nga Drejtoria e Bujqësisë.	04.16.1921	1

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
III-137	Vendim dhe korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Punëve të Brendshme mbi tokat e shitura në kohën e okupacionit grek në Qarkun e Prefekturës së Korçës.	03.19.1921 - 08.06.1921	9
III-138	Korrespondencë mbi prishjen e një sasive drithi dhe marrje masash për hetimin e çështjes.	09.27.1921 - 09.29.1921	3
III-139	Qarkore e Këshillit të Ministrave drejtuar gjithë prefekturave mbi të drejtën e kullotës.	07.28.1921	3
III-140	Korrespondencë mbi kërkim aprovimi për projektin e ligjit të pyjeve.	10.10.1921 - 12.27.1921	6
III-143	Vendim dhe korrespondencë mbi emërime, transferime, pushime të kuadrit të Ministrisë së Punëve Botore.	03.20.1921 - 06.23.1921	12
III-144	Projektligj për punëtorët e botores.	06.19.1921 - 06.24.1921	3
III-145	Vendim i Këshillit të Ministrave, etj. mbi përcaktimin e kompetencave të disa strukturave të Ministrisë së Punëve Botore dhe Ministrisë së Bujqësisë.	10.27.1921 - 10.31.1921	2
III-146	Ligj, veprime, rregullore, etj. mbi ndërtim urash, rrugësh, shtëpish, etj.	01.10.1921 - 12.14.1921	100
III-147	Korrespondencë mbi rregullimin e rrugës Drin - Mat.	09.24.1921 - 11.29.1921	2
III-148	Korrespondencë mbi dërgimin e numrit të punëtorëve, kafshëve, qereve, etj. për ndreqje rrugësh.	06.22.1921	1
III-149	Projektligj për dënimin e atyre që marrin, vjedhin, prishin materialin e urave të hekurudhave të dekovilit.	11.04.1921 - 11.27.1921	1
III-150	Vendim, etj. mbi nëpunësit e monopoleve që do të kënen të drejtat si gjithë nëpunësit e tjerë.	08.29.1921 - 09.11.1921	6
III-151	Korrespondencë mbi lejen për hapjen e një dyqani nga një person.	08.25.1921	1
III-152	Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme me Kryeministrinë mbi masat që do të merren për ata tregtarë që nuk respektojnë kursin e arit të caktuar.	04.30.1921	1
III-153	Vendim, korrespondencë, etj. mbi caktimin e sendeve që blihen nga zyrat shtetërore dhe formimin e komisioneve për këtë çështje.	03.13.1921 - 11.02.1921	9
III-154	Vendim, korrespondencë, etj. mbi shitjen dhe blerjen e mallrave, si dhe komisionet e blerjeve.	01.30.1921 - 11.17.1921	20
III-155	Korrespondencë mbi kontrabandën.	03.04.1921 - 04.26.1921	2
III-156	Korrespondencë mbi çmimin e disa teshave të blera nga zyrat shtetërore.	04.30.1921 - 08.22.1921	5

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
III-157	Listë dhe korrespondencë mbi çmimet e bukës së grurit të blerë nga Drejtoria e Shëndetësisë për spitalet.	07.27.1921 - 08.02.1921	4
III-161	Procesverbal, etj. mbi moskryerjen me rregull të detyrave nga ana e zyrtarëve telegrafikë.	01.03.1921 - 07.21.1921	8
III-162	Korrespondencë mbi shpërdorimin e materialeve të dekovilit.	05.21.1921 - 09.28.1921	10
III-163	Kërkesë e popullit të Kavajës mbi mosqënien në gjendje të paguajë hekurat e dekovilit të marra për rrethimin e varezave.	09.08.1921 - 09.13.1921	2
III-164	Korrespondencë e Prefekturës së Shkodrës me Qeverinë që për marrjen e trarëve të hekurit të lajmërohen zyrat kompetente që të mos kërkojnë trarët e hekurit por të falen.	10.23.1921	1
III-165	Korrespondencë mbi ankimin pa të drejtë të shoqërisë dekovilit për një kontratë transportimi.	11.23.1921 - 11.26.1921	2
III-166	Korrespondencë e Kryeministrisë me Drejtorinë e Përgjithshme të Punëve Botore, mbi furnizimin e prefekturave me automobila.	02.03.1921	1
III-168	Korrespondencë e Kryeministrisë me Ministrinë e Punëve Botore, mbi dërgimin e një kamioni Komandës së Përgjithshme të Gjindarmërisë për nevojat e saj.	03.24.1921 - 06.17.1921	5
III-169	Telegrame, etj. për lënien e disa veturave, etj. në dispozicion të disa zyrave me qëllim që t'i përdorin për nevojat e tyre.	01.03.1921 - 11.26.1921	24
III-170	Vendime, etj. mbi automobilat e Vlorës e të Gjirokastrës që do t'i shiten ushtrisë për nevojat e tyre.	03.05.1921 - 03.20.1921	7
III-171	Telegrame nga Prefektura e Durrësit drejtuar Kryeministrisë mbi prishjen e burgjijave të depozitës së automobilat, i cili ka shkuar të marrë në Durrës Xhafer Ypin.	04.10.1921	1
III-172	Vendim mbi dhënien e lejes për punim të automobilave në Pogradec dhe Korçë dhe vagonave në liqenin e Ohrit, francezit Veaty.	03.15.1920 - 08.11.1921	4
III-173	Korrespondencë mbi dhënie veglash për makina e benzinë si dhe automjjet.	04.13.1921 - 11.03.1921	4
III-174	Korrespondencë mbi mbajtjen e barit me automobilat e PTT-së. Kërkohet sa kilogram të vërë në një automobil.	02.26.1921	1
III-175	Korrespondencë mbi shoferët që marrin pasagjerë me automobilat e qeverisë (me lekë) dhe masat kundrejt tyre.	03.21.1921	3

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
III-176	Korespondencë e Kryeministrisë me Ministrinë e Punëve të Brendshme mbi caktimin e orarit të avulloreve nëpër ishujt e Shqipërisë dhe marrja e fabrikës nga ana e tyre për veprim.	02.19.1921 - 05.24.1921	2
III-177	Korrespondencë e Prefekturës së Vlorës me Kryeministrinë mbi mbyrtjen e dy barkave.	01.27.1921 - 02.01.1921	2
III-178	Lajmërimet që në portin e Shkodrës gjendet barka me motor "Drita", kurse në portin e Shëngjinit barka me motor vajguri dhe barka me motor benzine nuk gjinden.	11.03.1921 - 11.09.1921	4
III-179	Korrespondencë mbi kaikët të mbytura në Pashaliman.	01.30.1921	1
III-180	Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme me Kryeministrinë mbi raportin e Prefekturës së Shkodrës mbi çështjen e vaporëve të axhensisë "Logd".	03.29.1921	2
III-181	Kërkesë lejesh për ardhje vaporësh.	06.25.1921	1
III-182	Telegrame nga Kryeministria drejtuar prefekturave Vlorë dhe Durrës mbi dërgimin e dy barkave në Vlorë me benzinë, për të marrë prej andej fuqinë vullnetare dhe municionin italian.	09.27.1921	2
III-183	Telegram mbi dërgimin e kapitenit të limanit të Durrës për rregullimin e makinave.	01.12.1921	1
III-184	Lutje e tij dhe korespondenca të Kryeministrisë me Ministrinë e Punëve Botrore e Ministrinë e Bujqësisë mbi dhënie leje personave të ndryshëm për nxjerrjen e materialeve nga deti të mbytura gjatë luftës.	02.20.1921 - 10.24.1921	23
III-185	Lutje e Mahmut Shehut dhe Qazim Vokopolës drejtuar Kryeministrisë mbi dërgimin në Austri për t'u stërvitur në degën e aeroplanëve.	11.22.1921	1
III-186	Lutje e Kryetarit të Dërgatës në Romë drejtuar Kryeministrisë mbi rregullimin e postave dhe për këtë duhet të blihen gjithë materialet e lëna nga italianët.	11.04.1921	7
III-187	Korrespondencë e Kryeministrisë me Drejtorinë e Përgjithshme të Postë - Telegrafave mbi heqjen e postave dhe të stacioneve radio - telegrafike italiane nga Shqipëria.	11.19.1921 - 11.22.1921	3
III-188	Shkresa mbi letrën e Esat Pashë Toptanit ardhur nga Napoli i Italisë e cila më parë ju dorëzua Kryeministrisë.	06.10.1921	2
III-189	Korrespondencë mbi marrjen e një plike të mbullur nga Shoqëria Italo - Shqiptare nga Vlora.	04.15.1921	1
III-190	Korrespondencë mbi ardhjen e postës së Evropës dhe shpërndarja e saj me kohë.	09.29.1921 - 10.14.1921	4
III-191	Korrespondencë mbi marrje për komunikacion dhe për postën e jashtme me jashtë shtetit.	05.03.1921 - 06.10.1921	4

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
III-192	Korrespondencë mbi transferimin e Stacionit Postë - Telegrafik të Kukësit.	07.02.1921	1
III-193	Korrespondencë e Zëvendëskryeministrit me Drejtorinë e Përgjithshme të Postë - Telegrafave mbi këmbimin e postave me pako e thasë të rregullt midis dy shteteve.	06.27.1921 - 11.04.1921	6
III-194	Korrespondencë mbi fillimin e shërbimit telefonik të stacioneve Dajç e Mjedë, Zall dhe Klos.	01.24.1921 - 07.20.1921	2
III-196	Shkresë mbi korrespondencën telegrafike me shifra të përfaqësuesve të shteteve të huaja.	10.08.1921	1
III-197	Qarkore mbi mosbërjen e telegrameve pa rëndësi, për ndryshe taksa u ngelet për të paguar.	01.13.1921 - 10.22.1921	9
III-198	Korrespondencë e Prefekturës së Durrësit me Kryeministrinë mbi telegramin e Z. Sejfi për Romë, i cili duhej dhënë me të holla për të mos humbur kohë, u dha me anë të radios.	12.05.1921	2
III-199	Korrespondencë e Kryeministrisë me Drejtorinë e Përgjithshme të Postë ,Telegrafeve e Telefonave mbi kthimin e dëftesave e telegrameve Jusuf Buogës (deputetit të Durrësit).	09.27.1921 - 10.06.1921	3
III-200	Korrespondencë mbi ardhjen e një telegrami shifër në zyrën e Kavajës nga Irfan Beu.	12.12.1921 - 12.14.1921	3
III-201	Korrespondencë mbi mospranimin e telefonave ose telegrameve pa patur vulën ose firmën e asaj ministrie nga e cila vijnë, si dhe adresimi gabim i një telegrami.	09.29.1921 - 12.14.1921	4
III-202	Telegrame të ardhura nga jashtë mbi rregullimin e rrugëve telegrafike me jashtë.	04.19.1921	3
III-203	Korrespondencë mbi prishjen e markonit telegrafik Vlorë dhe bërje e këtyre veprimeve me anën e kanalit të Durrësit.	01.15.1921 - 01.16.1921	4
III-204	Vendim, korrespondencë, etj., mbi taksat postare, pullat, etj.	01.07.1921 - 12.29.1921	22
III-205	Korrespondencë mbi vajtjen e Sulejman Starovës në Itali, etj., për shtypjen e pullave të monopolit.	07.28.1921	1
III-207	Korrespondencë mbi shtypjen e pullave me pamje qyteti.	10.11.1921 - 12.01.1921	3
III-208	Raport i Kryeministrisë, etj., të paraqitur nga komisioni shqiptar, etj., mbi çështjen e pullave.	03.08.1921	22
III-209	Procesverbale mbi suxhenimin e pullave.	01.27.1921 - 09.26.1921	12
III-210	Korrespondencë mbi caktimin e çmimit të mandatpostave vetëm për në Shqipëri.	09.03.1921 - 10.15.1921	2
III-211	Ligj dhe korrespondencë e Kryeministrisë me Drejtorinë e Përgjithshme të Postë - Telegrafeve mbi rregulloren e letrave me vlerë të shfaqur e brendshme e përbërë nga 26 nene.	04.02.1921 - 06.21.1921	16

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
III-213	Shkresë mbi lajmërimin e zyrës së Lushnjës për dërgimin e aparatit të prishur për meremetimin, pasi tani ka makina të reja dhe sigurimi i korrespondencës bëhet me makinën marrëse që ka ajo zyrë.	06.25.1921 - 06.30.1921	1
III-214	Korrespondencë mbi sjelljen e disa aparateve telefonik, si dhe instalimet e tyre nëpër zyra e shtëpi.	03.26.1921 - 10.03.1921	16
III-215	Vendime, etj. dhe korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Financave mbi emërimet, pushime, transferime, etj. të nëpunësve të sektorit të financës.	01.31.1921 - 12.31.1921	90
III-216	Raporti i Komisionit të Buxhetit mbi pakësimin e disa nëpunësve dhe shkurtrimin e disa zyrave nëpër dikastere të ndryshme dhe për arsye buxheti.	01.26.1921 - 02.16.1921	46
III-217	Lutje e Luigj Babës, Drejtor i Përgjithshëm i Njehsimit në Ministrinë e Financave, drejtuar Këshillit të Lartë mbi protestën kundër Ministrit të Financave, Ahmet Daklit.	11.09.1921 - 11.19.1921	6
III-218	Vendim i Këshillit të Ministrave mbi mbajtjen e rregullit të kontabilitetit të përgjithshëm.	03.26.1921 - 03.30.1921	2
III-219	Vendim mbi kontrollimin e llogarive nga nëpunësit e financave.	08.26.1921	1
III-220	Korrespondencë me Ministrinë e Financave, etj., mbi bërjen e veprimeve nga ana e Arkës së Përgjithshme vetëm para dreke.	11.15.1921 - 11.16.1921	2
III-221	Telegrame dhe korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Financave mbi disa abuzime.	05.27.1921 - 10.09.1921	4
III-222	Buxheti i Shtetit për vitin 1921 me ndryshimet e kërkuara dhe të bëra gjatë vitit.	01.04.1921 - 12.04.1921	177
III-225	Korrespondencë mbi të ardhurat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shëndetësisë për vitin 1921.	01.27.1921 - 08.13.1921	4
III-226	Qarkore mbi ligjin që ndalon mosprishjen e të ardhurave financiare.	08.11.1921 - 08.13.1921	2
III-227	Korrespondencë mbi disa veprime të arkës për dhënie fondesh financiare.	01.23.1921 - 09.10.1921	15
III-228	Korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Financave mbi emërtimin e monedhës.	10.26.1921	1
III-229	Shkresë dërguar Prefektit të Beratit për të dërguar një çek për një amerikan në Korçë.	01.02.1921	1
III-230	Korrespondencë mbi kërkesën e disa tregtarëve për zhvendosjen e një sasi koronash të vulosura nga okupacioni italian.	01.26.1921 - 03.13.1921	6
III-232	Telegram dërguar Prefekturës së Durrësit për të sqaruar se sa është e vërtetë që Banka e Napolit ka falimentuar.	02.14.1921	1
III-233	Vendim dhe korrespondencë mbi ndalimin e eksportimit të arit dhe argjendit.	10.10.1921 - 11.03.1921	21

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
III-234	Shkresë dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme mbi dhënien e një huaje të brendshme.	01.24.1921	1
III-235	Korrespondencë mbi shtypjen e 40.000 copë huan e brendshme në Itali.	02.06.1921	1
III-236	Vendime, korrespondencë mbi të dhjetat, afatet e pagimit, etj. veprime për këtë çështje.	03.26.1921 - 12.31.1921	82
III-238	Korrespondencë mbi pagimin e taksës së bereqetit.	04.23.1921	10
III-239	Ligj, etj. mbi rregulloren e tatimit mbi ndërtesat, tokën, mbi nëpunësit e taksat e tjera.	09.25.1921 - 11.05.1921	33
III-240	Vendim, etj. mbi marrje takse shtetëror.	08.24.1921 - 08.27.1921	8
III-242	Vendime, etj. mbi taksën e xhelepit e vergjisë, faljen e të tjera veprime për këtë çështje.	02.13.1921 - 12.27.1921	28
III-243	Vendim, etj. mbi taksat limanore, vaporët dhe taksë shëndetësore.	01.08.1921 - 11.07.1921	18
III-244	Ligj, etj., mbi taksat e veprimeve të shtetit civil.	02.02.1921 - 10.01.1921	9
III-245	Rregullore, etj. mbi taksat e jetëshkrimeve.	06.28.1921 - 11.24.1921	6
III-246	Korrespondencë e Kryeministrisë me Ministrinë e Drejtësisë mbi nenet e marrjes së taksave të shpenzimeve gjyqësore në çështjet ndëshkimore prej një grosh në një frangë ari.	04.16.1921 - 04.20.1921	3
III-247	Ligj dhe korrespondencë e Qeverisë në Ministrinë e Financave mbi taksën për transportimin e drithit.	08.11.1921 - 10.08.1921	2
III-248	Korrespondencë e Ministrisë së Punëve Botore me Kryeministrinë mbi taksën që do të merret për kalimin e urës së Shijakut.	05.07.1921	1
III-249	Vendim, korrespondencë, etj. mbi taksë për lëndët ndërtimi si çimento, trarë, etj.	01.25.1921 - 04.12.1921	43
III-250	Korrespondencë mbi taksën e kripës.	02.03.1921 - 09.06.1921	8
III-251	Korrespondencë e Ministrisë së Financave me Kryeministrinë mbi taksën e arbitrazhit.	01.13.1921 - 10.19.1921	2
III-252	Vendim, etj. mbi uljen e taksës kadastral (tapive, etj.).	06.22.1921 - 12.06.1921	4
III-253	Ligj mbi taksën e rrugëve.	06.05.1921	2
III-255	Korrespondencë mbi taksën e mishit të demit.	04.13.1921	1
III-256	Korrespondencë e Drejtorisë së Përgjithshme të P. të Brendshme me Kryeministrinë mbi taksën që do të merret për nxjerrjen e qymyrgurit.	01.19.1921	2
III-257	Korrespondencë mbi ndryshimin e disa neneve në ligjet mbi taksat dhe shpenzimet gjyqësore, mbi qiratë e shtëpive, mbi internimin.	04.25.1921 - 05.18.1921	2
III-258	Vendim mbi lehtësimin e pagimit të borxhit të dhetarëve.	07.04.1921	2

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
III-259	Vendim, etj. mbi një shtesë buxheti për kompleksin, nga zbritja e tepërt nga marrja e taksave gabim për vitin 1921.	04.16.1921 - 05.30.1921	3
III-260	Vendim e korrespondencë mbi marrje takse për kinematografinë.	05.03.1921 - 09.07.1921	9
III-261	Korrespondencë mbi gjobat.	05.22.1921 - 11.26.1921	6
III-262	Vendim e korrespondencë mbi gjobat dhe shlyerje borxhi.	03.30.1921 - 11.18.1921	5
III-263	Vendim e korrespondencë mbi shpenzimet e bëra për Kryeministrinë, etj. në përgjithësi për jashtë shtetit nga persona të veçantë.	12.02.1920 - 12.20.1921	230
III-264	Vendime, korrespondencë, etj. mbi shpenzimet e bëra për ushtrinë.	01.10.1921 - 12.21.1921	140
III-265	Shkresa mbi hapje kredie për Ministrinë e Luftës.	06.21.1921 - 10.29.1921	3
III-267	Qarkore e Kryeministrisë mbi ndalimin e dhënies shpërblim dhe paradhënie nga arka dhe vënia në dispozicion të Kryeministrisë të një sasi fondi financiar nga ai i prefekturave.	08.21.1921 - 12.21.1921	5
III-269	Vendime etj. mbi shpenzimet e bëra për udhëtim e dietë.	07.12.1920 - 12.29.1921	65
III-270	Vendime dhe korrespondencë mbi shpenzimet e bëra për Ministrinë e Drejtësisë.	01.12.1921 - 11.30.1921	14
III-271	Vendime dhe korrespondencë mbi shpenzimet e bëra për Ministrinë e Punëve Botore.	01.10.1921 - 12.31.1921	81
III-272	Korrespondencë e katundarisë Durrës me Kryeministrinë mbi shpenzimet e bëra për tharjen e kënetave në Durrës, sepse po përhapej shumë malarja.	09.22.1921	2
III-274	Vendime dhe korrespondencë mbi shpenzimet financiare për Ministrinë e Arsimit dhe organet vartëse.	02.02.1921 - 12.31.1921	51
III-275	Korrespondencë mbi ankimet e studentëve shqiptarë që nuk marrin në rregull të hollat e tyre.	07.24.1921	1
III-276	Vendime dhe korrespondencë mbi shpenzimet e bëra për sektorin e shëndetësisë.	01.31.1921 - 09.24.1921	25
III-278	Vendime mbi sigurimin e ushqimit familjeve të dëshmorëve.	10.30.1921	2
III-279	Qarkore mbi mospranimin e lutjeve për avansa, mbasi dëmton arkën dhe shton punën e Ministrisë së Financave lejohet vetëm për raste të jashtëzakonshme.	02.01.1921 - 02.10.1921	2
III-280	Telegram i Kryeministrisë drejtuar Z. Zurani në Romë mbi shumën që duhet të japë për pagimin e shpenzimeve të dërgesës së darovave prej Kryqit të Kuq në Elbasan.	01.28.1921	3

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
III-281	Korrespondencë e Kryeministrisë me Ministrinë e Financave etj. mbi pagimin e 24.000 dollarësh Lidhjes së Kombeve për të prishurat e asaj Lidhje.	01.04.1921 - 01.20.1921	5
III-282	Vendime mbi dhënie leje disa personave për të shkuar jashtë shtetit për specializim dhe aprovimin e pagesave për shpërblime të ndryshme.	01.31.1921	2
III-284	Telegrami i disa personave tregtarë etj. të qytetit të Korçës mbi protestimin e tyre për të mos u vënë në zbatim ligji mbi pagimin e borxheve.	11.19.1921	1
III-287	Vendime etj. mbi marrje huaje për nevoja të ndryshme dhe për pagimin e tyre.	01.03.1921 - 07.18.1921	8
III-289	Rregullore shpenzimesh për gjyqet e Shën' Atit.	01.09.1921 - 01.20.1921	2
III-290	Korrespondencë mbi një konflikt për tokë midis fshatit Llakatund dhe çifligarit Syrja Vlora.	04.09.1921 - 09.13.1921	8
III-291	Vendim që tokat e quajtura në Burrel të Ahmet Zogollit, meqënëse janë në kufi me kullat e Pashës e të Pukjenit, sipas tapive të tija duhet të përfitojnë nga këto toka.	08.18.1921 - 08.18.1921	2
III-292	Korrespondencë e Qeverisë me Prefekturën e Durrësit etj. mbi ankesën e popullit të kësaj prefekturë etj. kundrejt një personi që i ndalon të presin dru në pyll dhe të tjerë për copëtimin e pyllit.	09.07.1921 - 11.08.1921	22
III-293	Korrespondencë mbi kërkesën e disa fshatarëve për një mosmarrëveshje për zotërim pylli.	05.04.1921 - 05.09.1921	7
III-294	Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme me Kryeministrinë mbi ankesën e pleqërisë së Bezhanit të Përmetit për kullotat që i ka marrë beu i Këlcyrës.	11.22.1921	1
III-295	Lutje dhe korrespondencë e Ministrisë së Drejtësisë me Kryeministrinë mbi ankesën e Xhemal Kastrecit për zaptimin e malit Milec (Korçë) nga fshatarët e atij fshati (Milec).	08.23.1921	1
III-296	Korrespondencë mbi kërkesën e një personi për ti dhënë një tokë të tij të marrë nga pasuria shtetërore.	06.30.1921 - 07.08.1921	3
III-297	Vendim, lutje dhe korrespondenca të Kryeministrisë me Ministrinë e Drejtësisë, Gjyqin e Lartë të Shën' Atit etj. mbi zgjidhjen e çështjeve të pasurive të trashëguara.	01.09.1921 - 11.20.1921	32
III-298	Korrespondencë me Ministrinë e Drejtësisë etj. mbi dërgimin për aprovim të një dekretligji, mbi ndarjen e sendeve të paluajtshme të bashkëzotëruara.	09.04.1921 - 09.19.1921	2
III-299	Vendime, si dhe korrespondencë e Kryeministrisë me Ministrinë e Punëve të Brendshme mbi nxjerrjen në ankand për shitjen e pasurive "Stani i Ri" në Kavajë.	03.19.1921 - 08.06.1921	6
III-300	Ligj i posaçëm për shpenzime (foqi - rahën) të pasurive të thjeshta (mylk) e të pronave (erazië).	02.02.1921 - 03.19.1921	8

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
III-301	Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme me Ministrinë e Punëve të Jashtme mbi mosdhënien e materialit të sekuestruar Z. Alqenijadhi Dhiamandit, sepse dëmtohet shteti, si dhe lutje e Izet Rerulit i cili kërkon pasurinë që i është zaptuar nga qeveria.	10.03.1921 - 10.21.1921	3
III-302	Korrespondencë e Këshillit të Naltë me Kryeministrinë mbi një lutje drejtuar asaj Kryesie nga tre tregtarë banues në Ujin e Ftohë të Vlorës, të cilët ankohen për vendimin e marrë për dhënien e dy shtëpive që janë ndërtuar në tokën e tyre prej italianëve, dy persona të tjerë.	04.04.1921	3
III-303	Shkresë mbi formimin e një komisioni për konfiskimin e materialeve për ata që i kanë blerë në ushtrinë italiane e austriake pa një dokument zyrtar.	05.21.1921	2
III-304	Shkresë e Ministrisë së Punëve të Brendshme mbi ankesën e një personi kundrejt Nënprefektit Ballsh, për marrjen e gurëve të shtëpisë së tij në interes të godinës qeveritare.	04.04.1921	1
III-305	Korrespondencë e Kryeministrisë me Ministrinë e Punëve të Brendshme mbi kërkesën që bëri Ali Qyteza që anëtar i Këshillit të Naltë Dr. Turtulli t'i lirojë shtëpinë.	04.25.1921	1
III-306	Korrespondencë mbi inspektimin që bëhet në vakëfet e Elbasanit të cilët janë rrënuar nga tërmeti.	01.20.1921 - 03.14.1921	3
III-3870	Fletë karakteristike e një specialisti të huaj amerikan, që ka ndihmuar në organizimin dhe drejtimin e Kryqit të Kuq në Shqipëri.	01.29.1921	2
III-3871	Lutje e fshatarëve të Gjirokastrës drejtuar qeverisë, për marrjen e masave në mbrojtjen e kullotave që u përkasin atyre.	04.28.1921	2
III-3872	Lidhje kontrate për punime botore dhe konditat përkatëse si dhe lutje e një shoqërie që merret me ndreqjen e urave e të rrugëve, e cila kërkon ndihmën e qeverisë për marrjen e masave dhe dhënie ndihme kësaj shoqërie.	06.23.1921	14
III-3873	Korrespondencë e Kryeministrisë me Këshillin Kombëtar mbi disa ndryshime të bëra në buxhet.	12.31.1921	1
III-3874	Ankesë drejtuar Kryeministrisë për pagesën e taksit të patentës.	12.20.1921	1
III-3875	Ligji i punëve për detyrimet e taksit rrugor si dhe lutje e pleqësisë së katundeve të Tiranës drejtuar Kryeministrisë, që detyruesat për punime botore të punojnë për hapjen e një rruge që është e leverdisshme për anën ekonomike të këtyre fshatrave.	10.05.1921 - 11.26.1921	9

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
III-3876	Korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Punëve Botore, mbi blerje material nga ushtria italiane për të ndihmuar të dëmtuarit nga tërmeti në krahinën e Tepelenës.	01.11.1921 - 04.15.1921	9
III-3877	Vendim i Këshillit të Ministrave mbi botimin në gazetë të lajmërimeve të dhëna nga zyrat e kadastrave në lidhje me shitjen e pronave (tokave) të shqiptarëve që ndodhen në Amerikë.	11.20.1921	1
III-3878	Lutje dhe korrespondencë mbi likuidimin e borxheve dhe llogarive karshi personave ose arkës.	03.19.1921 - 07.03.1921	5
III-4213	Lutje e një personi drejtuar Kryeministrit, mbi ngritjen e një fabrike moderne të përpunimit të dërrasës në Shqipëri.	02.13.1921	3
III-4214	Ligj mbi punimet e rrugëve.	11.26.1921	12
III-4215	Vendime dhe korrespondencë të Kryeministrit me Drejtorinë e Përgjithshme të Punëve Botore për lënien në dispozicion të Zyrës së Punëve Botore të Gjirokastrës një shume prej 4.000 franga ari për mbledhjen e materialit të dekovilit.	12.06.1921	2
III-4217	Telegram i Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, drejtuar Kryetarit të Qeverisë Shqiptare në Durrës, me të cilën e njofton se Konferenca e Tranzitit në Bari është caktuar më 10 mars.	01.18.1921	1
III-4218	Telegrame dërguar zotit Zurani në Romë dhe përfaqësuesit të qeverisë italiane në Durrës, lidhur me dërgim pajisjesh të ndryshme për Parlamentin si linoleum, perde etj.	02.25.1921 - 04.19.1921	9
III-4220	Vendim dhe korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Punëve të Brendshme, mbi përjashtimin nga taksat doganore të sendeve që ka sjellë katundaria e Shkodrës për nevojat e spitalit, si dhe faljen e taksit të disa tjegullave që ka sjellë Bashkia e Durrësit.	07.08.1921 - 07.12.1921	7
III-4221	Projekt dhe korrespondencë e Ministrisë së Financave mbi degët e Bankës së Bujqësisë e të dhjetave që i kanë disa persona privatë kësaj ministrie.	12.01.1921 - 12.03.1921	2
III-4222	Letër e përfaqësuesit të Legatës Italiane në Shqipëri, drejtuar Kryetarit të Qeverisë Iljaz Vrioni, me të cilën i përcjell një lutje të përfaqësuesit të firmës "Conti e Giorgi" që kërkon që rrjetet e lundrimit të kësaj shoqërie pas largimit të italianëve nga Vlora, të mos i nënshtrohen asnjë takse doganore.	03.16.1921	2
III-4223	Fatura dërguar kryeministrit mbi likuidim llogarish.	04.30.1921	3
III-4224	Telegram i Kryetarit të Qeverisë drejtuar ministrit Kostaldi në Durrës, me të cilën lutet që t'i telegrafojë banka për të derdhur shumën e caktuar.	09.02.1921	1

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
III-4225	Telegram i Gargjollës Pekmezit nga Vjena, për një çështje që lidhet me sigurimin e fondeve.	12.07.1921	1
III-4226	Letër e një përfaqësuesi të një firme në Stokholm, me të cilën do të dijë nëse Ministria e Financave në Shqipëri është e interesuar që firma në fjalë të marrë monopolin e shkrepsëve në Shqipëri.	10.16.1921 - 10.26.1921	1
III-4227	Telegram i Kryetarit të Qeverisë drejtuar Zuranit në Romë, lidhur me shpërndarjen e të hollave të dërguara për të ndihmuar të dëmtuarit nga tërmeti në Tepelenë.	03.12.1921 - 12.29.1921	4
III-4344	Reklamim i shoqërisë anonime të transportit "Adriatika" me qendër në Trieste dërguar Qeverisë Shqiptare për likuidimin e një shume të hollash për transportimin e 84 kutive me libra në Durrës.	06.11.1921	1
III-4345	Propozim drejtuar Kryeministrit mbi themelimin e një agjencie të përgjithshme me qendër në Romë, e cila do të kujdeset për të blerë të gjitha gjërat e nevojshme që Qeveria Shqiptare duhet ti blejë jashtë e që nuk prodhohen në vend.	12.26.1921	2
III-4346	Korrespondencë e Kryeministrit me Prefekturën e Vlorës për dërgimin e 5.000 franga ari dërgatës shqiptare në Paris, për nevoja të saj.	01.01.1921	3
IV	Arsim-Kulturë		
IV-25	Vendime etj. dhe korrespondencë të Kryeministrit me Ministrinë e Arsimit mbi emërime, pushime, transferime, dhënie leje të personelit arsimor.	01.25.1921 - 12.22.1921	53
IV-26	Projekt mbi kursin e mësuesve.	06.22.1921	6
IV-28	Korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Arsimit mbi rrogën 50 franga ari që u jepet nxënësve të Shkollës Normale të Elbasanit, të mos u jepet, por të mbahen me ushqimin e mbajtur në një vend për edukimin dhe mirëmbajtjen e tyre.	02.28.1921	1
IV-29	Ligji dhe dekretligji mbi organizimin qendror të Ministrisë së Arsimit.	11.22.1921 -	3
IV-30	Ligji mbi çështje arsimore.	05.21.1921 - 12.23.1921	81
IV-31	Vendime etj. dhe korrespondencë të Kryeministrit me Ministrinë e Arsimit mbi hapje shkollash.	07.23.1921 - 11.09.1921	8
IV-32	Telegram i Kryeministrit drejtuar Nënprefekturës së Lushnjës mbi lirimin e shkollës fillore që është zënë për nevojat e trupit arsimor të Shkollës së Bujqësisë.	05.06.1921 - 09.28.1921	2
IV-33	Vendim dhe korrespondencë të Kryeministrit me Ministrinë e Arsimit mbi pajisjen e shkollave me materiale të nevojshme.	04.27.1921 - 09.27.1921	2

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
IV-34	Telegrame drejtuar Kryeministrisë nga Prefektura e Durrësit mbi një shtëpi të cilën do t'a marri prefekti për ta përdorur si shkollë për të cilën thonë se ka qënë kishë ortodokse.	08.06.1921 - 08.07.1921	3
IV-35	Telegram dhe korrespondencë të Kryeministrisë me Ministrinë e Arsimit mbi ngritjen e një internati në Ballsh dhe jo në Cakran.	06.22.1921 - 08.02.1921	2
IV-36	Vendim, lutje dhe korrespondencë e Kryeministrisë me Ministrinë e Arsimit etj. mbi hapjen e Liceut Internat Privat për vajzat dhe mbi shpenzimet për këtë shkollë.	02.18.1921 - 07.07.1921	9
IV-37	Programi i gjimnazit të vogël .	s.d.	11
IV-38	Lutje etj. dhe korrespondencë të Kryeministrisë me Ministrinë e Arsimit etj. mbi dhënie bursash për të vazhduar shkollën jashtë shtetit.	03.23.1921 - 10.20.1921	17
IV-39	Vendim i Këshillit të Ministrave " Mbi moshapjen e shkollave private të huaja ".	09.14.1921	1
IV-40	Telegram i Mitropolitit Jakovi në Korçë drejtuar Kryeministrisë i cili kërkon të hapen shkolla greke dhe tregon se u burgos këtu prifti i Bilishtit i cili bashkohet me priftërinjtë paranome.	11.10.1921	1
IV-41	Korrespondencë e Kryeministrisë me Ministrinë e Punëve të Brendshme mbi krijimin e një kolegjii shqiptaro-amerikan në Kështjellën e Gjirokastrës.	07.28.1921 - 09.13.1921	3
IV-42	Korrespondencë e Kryeministrisë me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Prefekturën e Korçës e cila lajmëron se shkollat ku mësohej gjuha greke i ka marrë katundaria dhe ia ka dorëzuar Drejtorisë së Arsimit.	11.07.1921 - 11.18.1921	2
IV-43	Telegrame dhe korrespondencë e Kryeministrisë me Ministrinë e Arsimit etj. mbi hapjen e shkollës së vllëhëve në Korçë.	06.02.1921 - 12.27.1921	6
IV-44	Korrespondencë e Kryeministrisë me Ministrinë e Arsimit mbi ankimet e myftiut të përgjithshëm se nëpër shkollat e shtetit nuk bëhet mësim i rregullt zejtar.	04.11.1921 - 05.19.1921	3
IV-45	Qarkore mbi të mësuarit e mësimëve zejtare si librin e kursimit në shkollat e Qarkut të Korçës dhe të Gjirokastrës.	05.16.1921	1
IV-46	Vendim, rregullore si dhe korrespondencë përkatëse mbi hapjen e një gjimnazi të françeskajve në Shkodër.	09.05.1921 - 12.20.1921	14
IV-47	Korrespondencë e Kryeministrisë me Ministrinë e Arsimit mbi komisionin e vakëfeve të Vlorës që ka vendosur hapjen e një kolexhe.	07.22.1921	1
IV-48	Telegram mbi ardhjen e profesorit të Janinës për të studiuar sistemin tonë shkollor.	05.21.1921	2

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
IV-49	Vendim dhe shkresë mbi dhënien me qira shoqërisë " Drita " shtypshkronjën e Gjirokastrës.	05.19.1921 - 05.27.1921	2
IV-50	Korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Arsimit mbi ndalimin e shitjes së librit " Histori kronografike e Qarkut të Korçës" prej P.Harizit përderisa të shikohet edhe një herë prej Këshillit të Ministrave.	1921	1
IV-51	Terenc Toçi i drejtohet Kryeministrit se populli i Shkodrës kërkon të nxjerrë përsëri fletoren " Taraboshi " që ish botuar në 1913 -1914 në interes të kombit.	01.15.1921	1
IV-52	Korrespondencë e Kryeministrit me Drejtorinë e Përgjithshme të Shëndetësisë, Drejtorinë e Punëve Botore dhe Drejtorinë e Postë Telegraf Telefonave mbi dërgimin e një broshure që përmban bisedimet e Këshillit Kombëtar.	07.11.1921	2
IV-53	Korrespondencë mbi dërgimin e një libri që përmban gjithë qarkoret e vitit 1920.	07.18.1921	1
IV-527	Lutje e një profesori austriak drejtuar Qeverisë Shqiptare ku kërkon të vendoset në punë si specialist për çështjen e arsimit.	11.28.1904 - 11.13.1921	30
IV-590	Letër e Raul Vianit për Kryetarin e Qeverisë Shqiptare Pandeli Evangjeli, me të cilën kërkon disa të dhëna me qëllim përgatitjen e një broshure për shtetin e ri shqiptar.	10.20.1921	2
IV-607	Pjesë e shkëputur e cila flet mbi një dokumentacion të pasur për Shqipërinë që ndodhet në Austri dhe për këtë zoti Gjergj Pekmezi i kërkon Kryeministrit që të emërojë një përfaqësues fuqiplotë në Austri që të merret vesh direkt me qeverinë austriake, sepse këto nuk janë sende që shiten në treg për dokumente të rëndësishme dhe libra me vlerë që flasin për historinë e Kombit Shqiptar.	03.03.1921	3
IV-608	Vendim i Këshillit të Ministrave mbi raportin e paraqitur nga Profesor Dr. Gjergj Pekmezi, mbi çështjen e materialit të nevojshëm që ka Instituti Gjeografik Ushtarak i Vjenës për botimin e një harte speciale të Shqipërisë, si dhe marrëveshjen e gjithë materialit të statistikës së Shqipërisë dhe të librit gjermanisht që përmbledh historinë e zhvillimit të degëve të ndryshme të administratës shqiptare në kohën e pushtimit, etj.	03.08.1921	2
IV-609	Korrespondencë e Kryeministrit në Tiranë me Drejtorinë e Përgjithshme të Postë-Telegrafeve në Tiranë mbi çështjen e pullave postare me fotografinë e Skënderbeut, klishet e të cilave kanë mbetur në shtypshkronjën e shtetit francez në të cilën janë shtypur dhe të merren prej Përfaqësisë Shqiptare të Parisit e të mbahen prej saj.	02.08.1921 - 10.02.1921	2

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
V	Shëndetësia		
V-8	Vendime etj. dhe korrespondenca të Kryeministrisë me Drejtorinë e Përgjithshme të Shëndetësisë mbi emërime, pushime, transferime etj, të personelit shëndetësor.	01.13.1921 - 12.22.1921	58
V-9	Korrespondencë e Kryeministrisë me Këshillin Kombëtar etj. mbi dërgimin e projektligjit mbi rregullimin e personave të degës së shëndetësisë i propozuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shëndetësisë dhe i pranuar nga Këshilli i Ministrave.	07.15.1921 - 08.04.1921	2
V-10	Korrespondenca të Kryeministrisë me Drejtorinë e Përgjithshme të Shëndetësisë etj, mbi detyrat e mjekëve.	03.09.1921 - 04.23.1921	3
V-12	Vendim i Këshillit të Ministrave mbi të drejtat, lirinë e plotë për veprimet e saj që iu dha Drejtorisë së Përgjithshme të Shëndetësisë.	06.20.1921	2
V-13	Telegram nga Kryeministria dërguar prefekturave Berat dhe Vlorë ku njofton se do vijë atje një doktor i Kryqit të Kuq Amerikan dhe do të çeli një senatorium për të përmirësuar shëndetin e fëmijëve të të vobektëve.	03.15.1921 - 03.17.1921	3
V-14	Korrespondenca të Kryeministrisë me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Shëndetësisë mbi dorëzimin e spitalit të Durrësit Kryqit të Kuq Amerikan.	03.17.1921 - 05.14.1921	4
V-15	Korrespondencë e Kryeministrisë me Këshillin e Naltë mbi pranimin e ligjit paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shëndetësisë e përbërë prej 8 nenesh.	04.11.1921	1
V-16	Telegram i Kryeministrisë drejtuar Nënprefekturës Kavajë mbi lehtësimet që i duhen bërë Rexhep Jellës që po shkon atje bashkë me drejtorin e Kryqit të Kuq Amerikan.	07.18.1921	1
V-17	Korrespondencë e Kryeministrisë me Drejtorinë e Përgjithshme të Shëndetësisë dhe Këshillin Kombëtar mbi ligjin për rregullimin e shëndetit nga ana e limoneve i përbërë prej 39 nenesh.	04.30.1921 - 08.04.1921	2
V-18	Korrespondencë e Kryeministrisë me Drejtorinë e Përgjithshme të Shëndetësisë mbi ardhjen e dy doktorëve nga jashtë për të mjekuar sëmundjen e sifilisit.	09.13.1921	1
V-19	Lutje e kapedanëve të anijes së pilotëve të Grykës së Bunës të cilët kërkojnë të hapet zyra e karantinës në Grykën e Bunës.	02.02.1921	2
V-20	Raport mjekësor mbi Gjysho Abedinin i cili vuan nga sëmundja pulmonarie dhe me që kjo sëmundje është ngjitëse të veçohet.	05.11.1921	1

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
V-21	Korrespondenca të Kryeministrit me Ministrinë e Punëve të Brendshme etj, mbi sëmundjet e gjësë së gjallë dhe masat për shpëtimin e tyre.	04.06.1921 - 09.24.1921	3
V-22	Korrespondencë mbi dhënie leje për ushtrim profesioni farmacist.	09.09.1921 - 09.17.1921	3
V-23	Korrespondencë mbi hapjen e një farmacie.	08.03.1921	2
V-24	Korrespondencë e Kryeministrit me Drejtorinë e Përgjithshme të Shëndetësisë mbi urdhërat për mosdhënien e barnave të pasurve, por vetëm të vobektëve që janë të sëmurë dhe shtrohen në spital.	09.13.1921	1
V-25	Korrespondencë e Kryeministrit me Drejtorinë e Përgjithshme të Shëndetësisë mbi lënien të lirë të farmacisë " Buda " në Elbasan, mbasi po shkon farmacisti Taqi Buda për ta rregulluar sipas rregullave të shëndetësisë.	08.10.1921 - 09.07.1921	2
V-26	Shkresë mbi pranimin e propozimit mbi dërgimin e Dr. Ymerit në Europë për të blerë barna për spitalet.	05.15.1921	1
V-28	Telegram i Kryeministrit drejtuar Prefekturës së Vlorës dhe Elbasanit mbi ndihmën e Kryqit të Kuq të Francës i cili me ndërmjetësinë e shoqërisë " Fuller et Kokler " sollën 70 kasa plaçka për të vobektit, të dëmtuar nga tërmeti.	03.02.1921	2
V-29	Korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Punëve të Brendshme etj, mbi ndihmën e strehës varfnore.	02.08.1921 - 04.26.1921	2
V-30	Korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Punëve të Brendshme etj, mbi marrjen pjesë të qeverisë tonë në mbledhjen ndërkombëtare kundër tuberkulozit.	06.11.1921 - 06.22.1921	6
V-31	Telegram nga Prefektura e Durrësit drejtuar Kryeministrit mbi komisionet e Kryqit të Kuq Amerikan që të kenë leje kalimi kudo pa u nxjerrë pengesa.	08.20.1921 - 08.22.1921	2
V-32	Vendim i Këshillit të Ministrave mbi lejen për të ardhur në Shqipëri të priftit italian Lac Guzepe Adino di Paulo mbi shpikjen e një bari kundër malarjes.	12.31.1920 - 01.02.1921	3
V-267	Korrespondencë me Kryqin e Kuq Amerikan, lidhur me vënien në dispozicion të tij të një shume të hollash nga Qeveria Shqiptare dhe sigurimin e një banese për këtë ent.	02.28.1921 - 03.01.1921	2
VI	Civile-Administrative		
VI-18	Vendim, lutje, procesverbal etj. mbi ngritjen e moratoriumit në Korçë.	11.22.1920 - 06.06.1921	35
VI-26	Lista, korrespondencë etj. mbi regjistrimin e popullsisë.	01.15.1921 - 04.30.1921	9

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
VI-27	Lutje personash dhe korrespondencë me Ministrinë e Punëve të Brendshme për dhënie nënshtetësie.	02.05.1921 - 10.27.1921	6
VI-28	Korrespondencë e Kryeministrit me Këshillin Kombëtar e lutje mbi dhënie nënshtetësie shqiptare.	05.16.1921 - 07.09.1921	2
VI-29	Vendim, korrespondencë etj. mbi dhënie pasaporte dhe kontrollimi i tyre në kufi.	02.20.1921 - 07.16.1921	14
VI-30	Korrespondencë mbi një grua nga Shkodra e cila kërkon të shkojë në Jugosllavi.	07.17.1921 - 07.23.1921	3
VI-31	Telegram nga Prefektura e Lushnjës drejtuar Ilias Vronit për urim, i cili pranoi që të punojë në këshill.	04.12.1921 -	1
VI-32	Korrespondencë e Ministrit të Punëve të Brendshme me Kryeministrinë mbi kremtimin e ditës së hyrjes në Vlorë.	08.23.1921 -	1
VI-33	Telegram urimi me rastin e festave, krijimit të Qeverisë së Re, etj.	04.21.1921 - 12.28.1921	26
VI-34	Telegrame urimi dërguar nga persona të ndryshëm, Xhafer Ypit, me rastin e emërimit të tij Kryeministër.	12.25.1921 - 12.31.1921	207
VI-35	Telegrame mbi ardhjen dhe pritjen e disa personave për vizitë etj, në prefektura të ndryshme.	02.08.1921 - 12.28.1921	14
VI-36	Shkresë e Ministrit të Luftës dërguar Kryeministrit mbi orën në vendin tonë, ku duhet të jetë 1 orë më parë se ora e Grenoiçit dhe propozon që në mes të ditës të bjerë një top e jo këmbanë.	01.17.1921 -	2
VI-37	Urdhër i ditës më 3 gusht 1921.	08.03.1921 -	1
VI-38	Korrespondencë mbi paraqitjen e letrës së Myfit Libohovës, Këshillit të Ministrave, lidhur me kontradiktat me qeverinë greke për Korçën e Gjirokastrën.	09.26.1921 -	2
VI-39	Korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Financave mbi zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave në kohën e caktuar pa i bërë asnjë kundërshtim.	08.20.1921	1
VI-40	Qarkore mbi shpejtimin e veprimeve zyrtare në çdo akt zyrtar që dërgon çdo zyrë në këtë kryesi duhet të bëjë shkurtimin e lëndës.	08.12.1921 -	1
VI-41	Korrespondencë mbi rregullimin e varrezave të Gjirokastrës.	08.03.1921	1
VI-42	Paraqitet inventarizimi i kabinetit.	1921	3
VI-43	Qarkore mbi blerjen e portretit të Gjergj Kastriotit dhe të Donikës për t'i vënë nëpër zyra.	05.19.1921	1
VI-44	Qarkore dhe shkresa mbi ditët që kanë pushim zyrat me rastin e festave fetare etj.	01.06.1921 - 12.05.1921	26
VI-45	Korrespondencë kur kërkohen shpjegime nga një ministër, të na lajmëroni 4-5 ditë para për të patur kohë ajo që të na japë shpjegimet e duhura.	09.30.1921	2

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
VI-47	Listë, korrespondencë etj. mbi sasinë e sendeve që përmban kancelaria e Kryeministrit etj.	11.20.1920 - 03.16.1921	29
VI-48	Korrespondencë e Ministrit të Punëve Botore me Kryeministrinë mbi sigurimin me roje vendeve me rëndësi si industriale etj., të urdhërohet komisioni për shitjen e materialeve jashtë zonës së Vlorës, shoqërisë italiane.	05.19.1921	1
VI-49	Qarkore drejtuar gjithë ministrive mbi mosnxjerrjen jashtë të vendimeve, punët e tjera zyrtare pa u përfunduar krejtësisht dhe në rast të kundërt ndaj këtyre nëpunësve të merren masa deri në pushimin e tyre nga puna.	06.23.1921	1
VI-50	Qarkore, korrespondencë etj. me anën e të cilave njoftohet se faturat që vijnë nga jashtë papatur pullën e shtetit tonë nuk vihen në veprim.	02.01.1921 - 10.06.1921	4
VI-51	Korrespondencë e Qeverisë me Ministrinë e Punëve të Brendshme mbi lajmërimin e prefektit të Beratit për dorëzimin e ndërtesave që ndodhen në atë qytet, Ministrit të Luftës, me përjashtim të asaj godine që është rregulluar me ndihmën e popullit për shkollë.	02.24.1921 - 07.27.1921	2
VI-52	Korrespondencë mbi marrjen e shtëpisë së Shefqet Vërlacit, për pritjen e të huajve dhe shitje shtëpie.	04.29.1921 - 08.13.1921	2
VI-53	Korrespondencë e Ministrit të Punëve Botore me Kryeministrinë, mbi materialet e humbura në Durrës të kihet më shumë kujdes e të mblidhen në një vend.	05.20.1921 -	1
VI-54	Korrespondencë mbi kthimin e materialit të marrë nga ana e fshatarëve gjatë okupacionit.	05.21.1921 - 05.22.1921	2
VI-55	Shkresë mbi dorëzimin e teshave të parlamentit nga një person dhe lajmërimi që teshat e parlamentit do të vinë nga Bari.	04.27.1921 - 05.03.1921	3
VI-56	Telegram mbi rezolutën e Fan Nolit në Mitropoli në Prefekturën e Korçës, i shoqëruar me klerin.	12.21.1921 -	1
VI-58	Korrespondencë e Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve me Kryeministrinë mbi aprovimin e rregullores së administratës së vakëfeve.	03.09.1921	9
VI-59	Rregullore mbi organizimin e gjyqeve të Sheriatit në Shqipëri.	10.03.1921 - 10.05.1921	14
VI-60	Ligj dhe rregullore të Gjyqit të Naltë të Sheriatit.	10.07.1921	9
VI-61	Korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Punëve të Brendshme, mbi raportin e policisë së Korçës, mbi lëvizjet që bëhen në mitropolin e Korçës me anën e dhespotit Jakon kundër qeverisë.	05.11.1921	2
VI-62	Korrespondencë e Ministrit të Punëve të Brendshme me Kryeministrinë mbi organizimin e bektashinjve.	07.25.1921	1

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
VI-64	Telegram mbi ofizin e lartë që i propozojnë Nolit, ai nuk pranon.	12.07.1921 - 12.18.1921	2
VI-65	Korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Punëve të Brendshme mbi vendimin e popullit ortodoks dhe të klerit, mbi pavarësinë e kishës ortodokse.	12.21.1921 - 12.24.1921	2
VI-66	Korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Punëve të Brendshme, mbi përdorimin e gjuhës shqipe në kishat e Korçës dhe mbi marrjen jashtë të dhespotit të Korçës, Jakovi, si një përçarës i popullit të Korçës.	08.20.1921 - 12.01.1921	10
VI-67	Vendim, korrespondencë etj., mbi një mbledhje që bëhet me bektashinjtë në Prishtinë dhe statuti i tyre.	06.02.1921 - 08.08.1921	21
VI-68	Korrespondencë e Kryeministrit me Ministrinë e Punëve të Brendshme mbi regjistrimin e pasurive të vakëfeve.	01.11.1921 - 02.24.1921	2
VI-69	Korrespondencë e Ministrit të Punëve të Brendshme me Kryeministrinë, mbi ankimin e kryemyftiut nga disa artikuj gazetash kundra feve.	04.04.1921 - 04.16.1921	2
VI-70	Korrespondencë e Kryeministrit me Drejtorinë e Përgjithshme të Vakëfeve, mbi ankimet e popullit që çdo pasuri të konsiderohet vakëf dhe venë dorë për zotërimin e tyre.	03.25.1921 - 10.16.1921	10
VI-71	Qarkore etj., mbi ankimet që bëhen kundër zyrës së vakëfeve se gjoja pushton me forcë dyqanet që ndodhen në pronësi private.	10.17.1921 - 11.17.1921	3
VI-72	Korrespondencë mbi organizimin e një ceremonie fetare për përkujtim të vrasjes së një oficeri.	07.19.1921 - 07.21.1921	3
VI-73	Korrespondencë e Ministrit të Punëve të Brendshme me Kryeministrinë mbi teqenë e Melcanit.	08.26.1921 - 09.01.1921	1
VI-74	Telegram i komisionit kishtar të cilët kërkojnë që t'u jepen kyçet e Shëngjergjit pasi janë vonuar për 15 ditë.	06.30.1921	2
VI-75	Korrespondencë e vakëfeve të shtetit drejtuar Kryeministrit mbi njohjen e të drejtave myslimanëve ashtu si u njihen edhe të krishterëve nga ana e shtetit shqiptar dhe të marrë masa që Drejtoria e Arsimit të Korçës të lirojë ndërtesën e vakëfit që e përdor si shkollë.	08.26.1921 - 08.31.1921	5
VI-76	Qarkore e cila njofton se më 21 të këtij muaji ditën e hënë për qetësimin e shpirtrave të dëshmorëve që kanë rënë në lëvizjet kombëtare në kishën ortodokse dhe katolike do të thuhet një bedem, në xhami do të këndohet një mevlud.	11.20.1921	1
VI-95	Korrespondencë mbi administrimin e materialeve.	06.04.1921	1
VI-676	Telegram dërguar personaliteteve të qeverisë në raste feste ose njoftimesh të ndryshme.	03.21.1921 - 12.14.1921	4

Numri i dosjeve	Titulli	Viti (Filluar-Mbaruar)	Sasia e fletëve
VI-774	Shtojcë e ligjit " Mbi të drejtat e bashkive ".	12.25.1921	1
VI-775	Ligj i Kryeministrit " Për veprimtarinë dhe zbatimin e rregulloreve e gradave të nënoficerëve të ushtrisë ".	1921	3
VI-776	Kërkesë e Xhemal Bej Shijakut dërguar Kryeministrit mbi borxhin që duhet ti paguajë arkës së shtetit, lutja e të cilit nuk merret parasysh.	10.31.1921 - 11.14.1921	1